



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. ____, datë ____/____/2026

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE NË BASHKI DHE PROCEDURËN E SHQYRTIMIT TË ANKESAVE NË FUSHËN E KUJDESIT ALTERNATIV NË FAMILJE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 35, pika 4, të ligjit nr. 92/2025, "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Ky vendim përcakton:

- a) organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në fushën e kujdesit alternativ në familje në nivel bashkie;
- b) procedurën administrative për shqyrtimin e ankesave në fushën e kujdesit alternativ në familje;
- c) rregullat për marrjen, arsyetimin dhe njoftimin e vendimeve;
- ç) garancitë procedurale për mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Neni 2

Ngritja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave

1. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ngrihet pranë çdo bashkie, si një organ kolegjal i qendrueshëm administrativ, për shqyrtimin e çdo ankese që lidhet me proceset e vendosjes në kujdes alternativ në familje dhe trajtimit në familjen kujdestare.
2. Komisioni shqyrton ankesat që lidhen, në veçanti, me:
 - a) vendimet për përzgjedhjen, refuzimin ose largimin e familjeve kujdestare;
 - b) vendimet për vendosjen, transferimin ose ndërprerjen e vendosjes së fëmijës në kujdes alternativ në familje;
 - c) cilësinë dhe standardet e ofrimit të kujdesit në familjen kujdestare;
 - ç) çdo vendim tjetër administrativ të strukturave vendore që prek të drejtat dhe mirëqenien e fëmijës në kujdes alternativ në familje.
3. Komisioni ushtron funksionet në mënyrë të pavarur dhe të paanshme dhe në përputhje me legjisllacionin në fuqi.

4. Rregullorja brendshme e bashkisë përfshin rregulla për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.

Neni 3

Përbërja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave

1. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në fushën e kujdesit alternativ në familje krijohet me vendim të kryetarit/es të bashkisë dhe përbëhet nga 5 anëtarë, si vijon:
 - a) një përfaqësues të strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore në bashki;
 - b) një përfaqësues jurist nga njësi përgjegjëse për çështjet juridike në bashki;
 - c) një psikolog ose specialist për mbrojtjen e fëmijëve;
 - ç) një përfaqësues nga NJMF/NJVNR;
 - d) një anëtar tjetër me ekspertizë në fushën sociale.
2. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave drejtohet nga përfaqësuesi i strukturës përgjegjëse të shërbimeve shoqërore në bashki.
3. Punonjësit e emëruar anëtarë të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nuk kanë të drejtë të delegojnë anëtarësinë e tyre apo të zëvendësohen nga një anëtar tjetër në ushtrimin e kësaj detyre. Ato ndryshojnë vetëm me vendim të kryetarit të bashkisë, në përputhje me këtë vendim. Në rastet kur një anëtar/e nuk e ushtron më detyrën, kryetari i bashkisë menjëherë emëron në këtë detyrë një anëtar tjetër. Në rastet e mungesave të përkohëshme në detyrë, kryetari i bashkisë zëvendëson anëtarin/en me një tjetër zëvendësues të përkohshëm.
4. Anëtarët që janë në konflikt interesi, sipas legjislacionit në fuqi, përjashtohen nga shqyrtimi i një çështje dhe zëvendësohen menjëherë me vendim të kryetarit të bashkisë me një anëtar tjetër.

Neni 4

Parimet e organizimit dhe funksionimit

1. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave organizohet dhe funksionon në bazë dhe për zbatim të të gjitha parimeve të veprimtarisë administrative si Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit në fuqi.
2. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ushtron veprimtarinë në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.
3. Procedura e ndjekur nga Komisioni respekton procesin e rregullt ligjor. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka detyrimin për të dëgjuar fëmijën sipas moshës dhe pjekurisë.

Neni 5

E drejta e ankimit

1. Çdo fëmijë i përfshirë në procesin e kujdesit alternativ në familje, përfaqësuesi ose përfaqësuesi ligjor i tij, si dhe anëtarët e familjes biologjike ose të familjes kujdestare, kanë të drejtë të paraqesin ankim administrativ pranë Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, të ngritur pranë bashkisë, brenda 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni për vendimin.
2. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave shqyrton çështjet vetëm me kërkesë të palëve të interesuara.
3. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbështetjes nga bashkia për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesës.

Neni 6

Paraqitja dhe verifikimi paraprak i ankesës

1. Për ankesat drejtuar Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nuk kërkohet ndonjë formë e caktuar, por ato duhet të shprehin qartë objektin e ankimit ose të kërkesës, identitetin e ankuesit, rrethanat e faktit mbi të cilin ngrihet ankimi. Ankesa paraqitet në formë shkresore, me shkrim ose elektronikisht (postë elektronike), apo edhe para Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk pranon ankesa anonime, me përjashtim të rasteve kur ka indicie për shkelje serioze.
2. Për çdo ankesë krijohet një dosje e posaçme. Ankesat shqyrtohen sipas rendit të paraqitjes së tyre.
3. Çdo ankesë regjistrohet detyrimisht në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.
4. Ankuesit pajisen me një vërtetim me shkrim që konfirmon marrjen dhe regjistrimin e ankesës.
5. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, jo më vonë se brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga regjistrimi i ankesës verifikon kompetencën për shqyrtimin e saj, plotësimin e kushteve formale, të metat e ankesës, përfshirë edhe dokumentacionin shoqërues, dhe merr vendim për plotësimin e të metave apo mospranimin e ankesës.
6. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi njihet me ankesën për një shkelje në procesin e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje, vendos:
 - a) ta pranojë ose jo ankesën për shqyrtim;
 - b) t'i kthejë përgjigje të interesuarit, duke i treguar arsyet e mospranimit të ankesës;
 - c) në rast se është e mundur, t'ia kalojë çështjen organit kompetent.
7. Në rastet kur vërehen mangësi apo të meta në paraqitjen e ankesës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave kërkon me shkrim nga ankuesi plotësimin e të metave të ankesës, brenda një afati jo më shumë se 5 (pesë) ditëve kalendarike nga dita e marrjes së ankesës.
8. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave njofton ankuesin/it dhe të interesuarit menjëherë, por jo më vonë se brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga dita e regjistrimit të ankesës, marrjen e vendimit sipas pikës 6 (gjashtë) të këtij neni.
9. Çdo shërbim lidhur me ankesat dhe shqyrtimin e tyre është pa pagesë.

Neni 7

Shqyrtimi i ankesës

1. Ankesa shqyrtohet brenda 15 ditëve kalendarike nga regjistrimi i saj.
2. Komisioni përgjatë shqyrtimit të ankesës mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin përkatës, thërret dhe dëgjon palët; dëgjon fëmijën, në mënyrë të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin e tij.
3. Pas pranimit të ankesës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave kryen njërën nga veprimet e mëposhtme:
 - a) ndërmerret një proces hetimi për mbledhjen e informacionit dhe dokumentacionit përkatës me qëllim marrjen e të gjitha rrethanave, fakteve, provave të lidhura me procesin për të cilin është paraqitur ankesa;
 - b) kërkon shpjegime nga organet përkatëse e përfshira në procesin për të cilin është paraqitur ankesa;
 - c) cakton, kur vlerëson të nevojshme, një datë për kryejen e një seance dëgjimore me palët e përfshira në proces, si dhe dëgjon fëmijën, në mënyrë të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin e tij.

4. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave i kërkon dokumentacion dhe informacion çdo strukture të përfshirë në proceset e shërbimit të kujdestarisë alternative, kryen kqyrje në vend të akteve, dokumenteve ose kushteve që kanë lidhje me çështjen që hetohet, kërkon shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, merr informacione nga çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin, merr në pyetje çdo person apo subjekt që është i lidhur me çështjen, kryen seanca dëgjimore me ankuesin dhe palët e përfshira në proces, si dhe kryen ose kërkon kryerjen e ekspertizave të nevojshme në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative në fuqi.
5. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, të paanshëm dhe në interesin më të lartë të fëmijës, bashkëpunon dhe bashkërendon veprimtarinë me të gjitha institucionet dhe strukturat përkatëse, përfshirë:
 - a) Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijës (NJMF) dhe Njësinë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVNR);
 - b) Shërbimin Social Shtetëror;
 - c) strukturat përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel vendor;
 - ç) institucionet e sistemit të drejtësisë, sipas rastit;
 - d) institucionet arsimore dhe shëndetësore;
 - e) organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve.
6. Institucionet dhe strukturat e identifikuara dhe përcaktuara gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesës nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, sipas këtij vendimi, janë të detyruara të vënë në dispozicion të Komisionit, brenda afateve të kërkuara, informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e ankesës, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Mosdhënia e informacionit pa shkak të arsyeshëm përbën shkak për paraqitjen e një kërkesë nga Komisioni për fillimin e procedurave të shkeljeve ligjore ndaj subjekteve përkatëse.
7. Bashkërendimi ndërinstitucional realizohet nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, pjesëmarrjes në mbledhje, dhënies së opinionëve profesionale dhe çdo forme tjetër bashkëpunimi të nevojshme për shqyrtimin e plotë dhe të drejtë të ankesës.
8. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të cilat janë të dhëna personale apo janë konfidenciale. Anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave ruajnë konfidencialitetin e informacioneve për të cilat vihen në dijeni si rezultat i hetimit.

Neni 8

Mbledhja dhe vendimmarrja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave

1. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave thirret në mbledhje nga kryetari/ja i/e Komisionit menjëherë me regjistrimin e një ankese.
2. Secili anëtar i Komisionit ka të drejtën të aksesojë, shqyrtojë dhe trajtojë çdo akt të dosjes së shqyrtimit të ankesës.
3. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave përcakton hapat për shqyrtimin e ankesës, duke respektuar afatet sipas ligjit dhe këtij vendimi.
4. Kryetari/ja i/e Komisionit njofton anëtarët për çdo mbledhje duke informuar për orën, vendin dhe çështjet për të cilat thirret mbledhja.
5. Çdo ndryshim i datës dhe kohës së mbledhjet i njoftohet menjëherë anëtarëve të Komisionit por jo më vonë se 1 (një) ditë para datës së njoftuar të zhvillimit të mbledhjes.
6. Mbledhjet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave janë të vlefshme kur janë të

pranishëm të paktën 3 anëtarë të Komisionit. Vendimet e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave janë të vlefshme kur marrin vendim jo më pak se gjysma e antëtarëve të pranishëm të Komisionit. Vendimet merren me votim të hapur. Në rast barazimi votash, vota e kryetarit/es së Komisionit është vendimtare.

7. Çdo anëtar i Komisionit ka të drejtën e një vote.
8. Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, në të cilin përfshihen të gjitha diskutimet, si dhe votat kundër të anëtarëve të Komisionit. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit.

Neni 9 **Vendimmarrja**

1. Në përfundim të hetimit, brenda 15 ditëve kalendrike nga regjistrimi i ankesës, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave merr vendim të arsyetuar për ankesën, me shkrim, të qartë dhe të kuptueshëm, duke marrë parasysh moshën dhe zhvillimin e fëmijës.
2. Vendimi përmban
 - a) bazën ligjore;
 - b) analizën faktike;
 - c) përfundimet dhe vendimet;
 - ç) mjetet ligjore mbrojtëse, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative në fuqi.
3. Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave i njoftohet menjëherë, por jo më vonë se brenda 3 (tre) ditëve kalendrike pas marrjes së vendimit, ankuesit/ve dhe palëve të interesuara. Njoftimi kryhet në formë shkresore ose elektronike, në mënyrë që të sigurohet prova e marrjes së tij.
4. Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave i përcillet menjëherë me miratimin e tij strukturës përgjegjëse për ndjekjen e procedurave për zbatimin e tij.
5. Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave hyn në fuqi pas njoftimit të ankuesit dhe regjistrohet në Regjistrin Elektronik.

Neni 10 **Ankimi ndaj vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave**

Fëmija, prindërit e fëmijës, të afërmit e tij dhe palët që kanë një interes të ligjshëm, kanë të drejtën e ankimit kundër vendimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në gjykatën administrative, në përputhje me legjislacionin për gjykimin administrative në fuqi.

Neni 11 **Sekretariati**

1. Struktura përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki luan rolin e Sekretariatit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
2. Sekretariati siguron mbështetjen administrative dhe teknike të veprimtarisë së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave si dhe ndihmon në përgatitjen dhe dokumentimin e mbledhjeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
3. Në veçanti, Sekretariati ka këto detyra:
 - a) pranon dhe regjistron ankesat e paraqitura;
 - b) administron dhe arkivon dokumentacionin përkatës për çdo çështje;
 - c) përgatit materialet dhe dokumentacionin për shqyrtim nga Komisioni;

- d) njofton anëtarët e Komisionit dhe palët e interesuara për datën dhe rendin e ditës së mbledhjeve;
 - e) mban procesverbalin e mbledhjeve dhe siguron dokumentimin e vendimmarrjes;
 - f) ndjek zbatimin e vendimeve të Komisionit dhe komunikon me institucionet përkatëse;
 - g) siguron regjistrimin e ankesave dhe vendimeve në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.
4. Sekretariati ushtron funksionet e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe garanton ruajtjen e konfidencialitetit të informacionit.
 5. Sekretariati përgatit raportime periodike mbi ecurinë e ankesave dhe zbatimin e vendimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave. Raportet regjistrohen në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje.

Neni 12

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

1. Të dhënat personale në procedurat e shqyrtimit të ankesave trajtohen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Aksesit në të dhënat personale kufizohet vetëm për personat e autorizuar.
2. Anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave ruajnë sekretin profesional për çdo informacion të marrë gjatë procedurës së shqyrtimit të ankesave. Shkelja e konfidencialitetit sjell përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 13

Ngarkimi për zbatim

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi ministria përgjegjëse për çështjet sociale, Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës, njësitë e vetëqeverisjes vendore, strukturat përgjegjëse të mbrojtjes së fëmijës dhe strukturat inspektuese.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA